

KRYESORJA MBI TË DREJTAT E PACIENTËVE

PARARATHËNJE.....	2
1 -E DREJTA MBI ZGJEDHJEN E LIRË.....	3
2 - E DREJTA PËR INFORMIM.....	5
3 -HYRJET NË DOSJE.....	6
4 -SEKRETI PROFESIONAL.....	8
5 -PËLQIM I LIRË DHE I SQARUAR.....	10
6 - MASAT E DETYRUESHME.....	12
7 - E DREJTA PËR TË QENË I SHOQËRUAR	13
8 -UDHËZIMET E PARAKOZHSHME DHE PËRFAQËSUESIT TERAPEUTIK.....	14
9 - DHËNJJA E ORGANEVE DHE E INDEVE.....	16
ÇFARË DUHET TË BËHET NË RAST TË PROBLEMIT? RRUGËT PËR ANKESË.....	18
A. INSTANCAT E NDËRMJETËSIMIT TË ORGANIZATAVE PROFESIONALE.....	18
B. KOMISIONI KANTONAL I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE.....	18
KENI NEVOJË PËR NDIHMË, INFORMATA APO KËSHILLA? DISA ADRESA TË NEVOJSHME.....	19

PARATHËNJE

Secili nga ne, në një moment apo një tjetër, i ka rënë të këshillohet nga një profesionel i shëndetit apo iu është ofruar ndihmë nga entet shëndetësore.

Raportet në mes të pacientëve dhe botës së shëndetësisë janë të drejtuara sipas ligjeve ku pacientëve u njihen një mori të drejtash. Këto të drejta ende nuk njihen sa duhet nga popullata; për këtë qëllim Shërbimi i shëndetësisë publike të Kantonit Vaud ka dëshiruar ta përfitoj rastin që të hypet në fuqi rishqyrtimi i ligjit mbi shëndetin publik që të njihet sa më mirë.

Broshura e sotme ka për qëllim ta sensibilizoj publikun mbi të drejtat që u njihen nga ligji në raportet e tij me profesionelët e shëndetit. I informuar mirë, pacienti do të jetë më i përgatitur ta vlerësoj situatën dhe t'i vë në spikamë pikëpamjet e tij. Do të jetë gjithashtu pjesëmarrës duke i njohur gjërat mbi tretmanin që i propozohet. Për ta përmirësuar transparencën, ky publikim ka ambicje të promovon besimin reciprok për të kontribuar në cilësinë e raportit terapeutik.

Të drejtat kryesore të pacientëve janë të rigrupuara në nënt pjesë, secila e ndarë në tri mënyra të ndryshme:

- pjesa e parë e paraqet një rezyme përmbledhëse e çdonjërës nga të drejtat kryesore të pacientëve, duke cekur nenin apo nenet e ligjeve përkatëse ku lexuesi përkatës do të ketë mundësi të bazohet në të nëse dëshiron t'i njohë saktësisht tekstet ligjore ;
- pjesa e dytë, e titulluar « në praktikë », jep sqarime të nevojshme që të kuptohet mirë ligji;
- pjesa e tretë, e titulluar « është mirë të dihet » paraqet përgjigjet në pyetjet kryesore që publiku mund t'i shtrojë në lidhje me temat e prezentuara.

Poashtu, në fund të volumit, do të gjinden adresat e organizmave pranë të cilave mund të drejtohen personat që dëshirojnë të kenë informata plotësuese apo këshilla sikur edhe mbi mundësitë e ankesave që janë në dispozicion të pacientëve të cilët mendojnë se kanë arsye të ushtrojnë ankesë për shkak të shkeljes të drejtave të tyre.

Për ta përfunduar, t'a përkujtojmë se të drejtat e pacientëve nuk shkojnë pa disa përgjegjësi. Që tretmani të jetë efikas, duhet që profesioneli i shëndetit të ketë vërtet mundësinë të llogaris në pjesëmarrjen aktive të pacientit. Prandaj, i takon pacientit që t'a informoj shëruesin në mënyrën më të saktë që të jetë e mundur për sëmundjen dhe për tretmanet eventuale që i ka marrë. Është poashtu me rëndësi që pacienti ta vazhdojë tretmanin e përshkruar posa ta ketë pranuar. Dhe për fund, një marrëdhënje me mirësjellje dhe respekt, kontribuon në zhvillimin e një kuadri terapeutik cilësor.

Marc Diserens, shef i Shërbimit të shëndetit publik (shoqëror)
Dr Jean Martin, mjek kantonial

1 - E DREJTA MBI ZGJEDHJEN E LIRË

Në rast të tretmanit brenda ditës (ambulatorë), pacienti ka të drejtë ta zgjedh lirisht profesionelin e shëndetit të cilit dëshiron t'i drejtohet.

Ka të drejtë gjithashtu ta zgjedh lirisht entin shëndetësor ku ai dëshiron të jetë i mjekuar.

(Sipas nenit 20 të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Pacienti ka mundësi t'i drejtohet profesionelit të shëndetit që ai ka zgjedhur, megjithatë, profesioni mund ta dërgoj pacientin te një koleg nëse ai e vlerëson që nuk ka mundësi t'i mjekoj rastet e veçanta apo nëse nuk është i lirë.

Pacienti ka të drejtë të pranohet në entin shëndetësor publik që ai e ka zgjedhur. Megjithatë duhet që pacienti të ketë një shtrat të lirë dhe që ky ent me paisjet që ka, t'ia mundësojnë dhënjen e shërbimeve të duhura.

Në spitalet dhe entet shëndetësore publike, pacienti duhet të pranoj të jetë i mjekuar nga mjekët që i përkasin këtij enti. Nëse dëshiron, ai ka të drejtë të kërkoj një diagnozë nga një mjek tjetër jasht entit. Shumën e këtij konsultimi, pacienti vet duhet ta paguaj.

Përpos rastit urgjent ose udhëzimit mjekësor të veçantë (për shembull një mjekim që nuk mund t'i ofrohet në kanton), pacienti duhet të shtrohet në një spital të kantonit ku ai banon.

Duhet cekur se në disa raste, zgjedhja e pacientëve mund të jetë e kufizuar nga mbulesa e sigurimit që ai e ka zgjedhur. Në rast dyshimi rreth ndonjë mjekimi apo shtrirje në spital, është shumë e këshilluar të kërkonit paraprakisht sçarime pranë sigurimit tuaj. Shoqata zvicerjane e të siguruarve, adresa e së cilës është në fund të kësaj broshure, ka mundësi gjithashtu t'ju ofroj informata të nevojshme.

Është mirë të dihet

Çfarë mund ta kufizoj zgjedhjen e lirë të entit shëndetësor ?

Ka mundësi të jetë i kufizuar me anë të ndonjë rregulle të sigurimit që e kufizon zgjedhjen e lirë të siguresit, nëse mungojnë shtretërit ose paisjet e duhura në një EMS apo në një spital.

Çfarë ndodh nëse mjeku im operon vetëm në klinikë private ?

Nëse klinika nuk ka divizion të perbashkët dhe nëse ju nuk keni sigurim që mbulon shtrimin në një spital privat, një pjesë e shpenzimeve duhet të jetë e mbuluar nga ju. Është shumë e këshillueshme të informoheni paraprakisht pranë mjekut tuaj apo sigurimit tuaj.

Çfarë ndodh nëse e zgjedh një spital jasht kantonit Vaud kur gjëndja ime nuk është urgjente ose nuk ka karakteristika mjekësore të veçanta ?

Nëse nuk e keni bërë një sigurim plotësues që i mbulon këto raste, ju duhet t'i paguani një pjesë të shpenzimeve. Është shumë e këshillueshme t'i kërkonit sçarime mjekut apo sigurimit tuaj.

A kam të drejtë ta zgjedh entin mediko-social (EMS) ?

Jeni i lirë të zgjedhni EMS ku dëshironi të qëndroni dhe keni mundësi ta ndërroni atë nëse dëshironi. Megjithatë, do të duhej ta zgjedhni një EMS misioni i të cilit është (gjeriatri ose psikogjeriatri) t'i përshtatet gjendjës suaj. Por megjithatë, duhet ta keni parasysh që EMS-i që ju keni e zgjedhur, nuk do të ketë gjithsesi vend të lirë në kohën kur dëshirohet.

A kam mundësi ta zgjedh mjekun tim nëse qëndroj në një EMS ?

Po. Keni të drejtë ta konsultoni një mjek jasht entit nëse dëshironi. Ky konsultim do të jetë i paguar nga sigurimi bazë.

Çfarë do të ndodhte nëse e zgjedh një EMS jasht kantonit Vaud që të afrohem pranë fëmijëve të mij?

Kjo nuk do të ketë pasojë në rentën tuaj AVS/AI dhe pagesat plotësuese të përcakëtuara nga ligjet federale. Por, nuk do të keni të drejtë për ndihmat e parapara nga LAPREHEMS, ligji vaudois për ndihmat ndaj personave që kërkojnë një strehim mediko-social. Në disa raste, keni megjithatë mundësi të merrni ndihma nga ndihmat sociale vaudoise, por një pjesë e shpenzimeve për përkujdesjen e pacientit duhet kthyer, dhe mund t'i kërkojnë familjes. Është pra e këshilluar të pyesni për cilat ndihma do të keni të drejtë në kantonin ku gjendet EMS që e keni zgjedhur.

2 – E DREJTA PËR INFORMIM

Pacienti ka të drejtë të informohet në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme mbi gjendjen shëndetësore, mbi vizitën dhe mjekimin e paraparë, mbi pasojat dhe rreziqet që eventualisht implikohen, mbi parashikimin dhe mbi aspektet financiare të mjekimit.

Nëse pacienti dëshiron, mund ta kërkojë çdoherë një mendim të dytë mjekësor pranë një mjeku tjetër.

Në momentin e pranimit në një ent shëndetësor, pacienti duhet të merr informata me shkrim mbi të drejtat dhe detyrimet dhe mbi kushtet gjatë qëndrimit të tij.

(Sipas nenit 21 të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Profesionelët e shëndetit duhet ta njoftojnë pacientin spontanisht. Duhet t'i komunikohet në mënyrë objektive dhe të tërësishme me të gjitha informatat e nevojshme që të mund t'i njeh gjërat që kanë të bëjnë me mjekimin.

Informata mund të jetë megjithatë e kufizuar, ose edhe të mungoj në dy raste :

- Nëse pacienti kundërshton në mënyrë të qartë me qenë i informuar, për shembull nëse nuk dëshiron ta dijë se është apo jo sëmundja e pashërueshme;
- Në raste urgjente ; informata lihet t'i ipet më vonë.

Informata i drejtohet vetëm atij, pacientit. Përballë personave të tjerë (duke marrë parasysh edhe kolegët që nuk marrin pjesë në mjekim), profesionelët e shëndetit janë të detyruar ta ruajnë sekretin.

Nëse pacienti e cakton një përfaqësues terapeutik (duhet shiquar kapitullin ” direktivat e parapara dhe përfaqësuesi terapeutik”) profesionisti i shëndetit duhet ta furnizoj me informatat ashtu si duhet. Fshehtësia (sekreti) profesionale mund t'i zbulohet përfaqësuesit terapeutik, nëse është e nevojshme.

Nëse pacienti dëshiron ta kërkojë një mendim të dytë mjekësor, ka të drejtë të këshillohet me mjekun që e ka zgjedhur vet. Ky këshillim do të paguhet nga sigurimi bazë. Në spitale mund ta kërkojë një mendim të dytë nga një mjek jashtë atij enti. Shpenzimet e këtij këshillimi të jashtëm megjithatë do të jenë në ngarkesë të pacientit.

Është mirë të dihet

Përse kërkohet një mendim i dytë mjekësor ?

Mendimi i dytë mjekësor nuk është një akt mosbesimi ndaj mjekut. Qëllimi i tij është ta përmirësojë informatën e pacientit në mënyrë që të mund të vendosë në dijeni të çështjes se a do pranojë apo jo mjekimin e propozuar.

Në cilat raste mund ta kërkohet një mendim të dytë mjekësor ?

Pacienti mund të kërkojë një mendim të dytë mjekësor në çfarëdo kohe. Kjo orvatje është veçanërisht e nevojshme për një intervenim kirurgjikal jo të ngutshëm apo një mjekim të rëndë që i propozohet.

3 – HYRJET NË DOSJE

Pacienti ka të drejtë ta kërkojë dosjen dhe t'i shpjegohet domethënja.

Mund t'i ipen dokumentet falas parimisht, origjinali apo kopja, dhe mund t'ia kumtojë profesionelit të shëndetit që e ka zgjedhur vet.

(sipas nenit 24 të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Kjo e drejtë nuk përfshihet në shënimet e marrura nga profesioneli për nevojat e tij personale, as në informatat që kanë të bëjnë për dikë tjetër e të cilat janë të mbrojtura nga sekreti profesional.

Aq më tepër, nëse profesioneli i shëndetit mendon që konsultimi i dosjes mund të ketë pasoja të rënda për pacientin, mund të kërkojë që ky konsultim të bëhet në praninë e tij, apo në praninë e një profesioneli tjetër që e ka zgjedhur vet pacientin.

Është mirë të dihet

Nëse një i afërm i imi apo një profesionel i shëndetit dëshiron ta konsultoj dosjen time ?

Të afëmit tuaj apo një profesionel i shëndetit nuk mund ta konsultoj dosjen tuaj nëse ju nuk e jepni qartë pëlqimin tuaj.

Profesioneli i shëndetit a mund të kundërshtoj që të ma tregoj dosjen time, apo të ma tregoj pjesërisht ?

Jo, vetëm nëse është fjala për shënimet personale ose për informatat që kanë të bëjnë për dikë tjetër. Mundet megjithatë që ai të kërkojë ta konsultoni dosjen vetëm në prani të tij.

Çfarë ndodh me dosjen time nëse vendosni t'ia jap një profesioneli tjetër të shëndetit ?

Mund të kërkonit që dosja juaj t'ju ipet në duar apo që t'ia ipet profesionelit të ri të shëndetit që e keni zgjedhur. Në rast se kundërshtohet apo ngurrohet kjo, ju mund të kërkonit pranë instancave për ndërmjetësim ose në Komisionin që ekziston për ankesa.

Cilat janë dokumentet që i përmban dosja e pacientit ?

Dosja e pacientit përmban konstatimet faktuale të profesionelit të shëndetit (historia mjekësore e pacientit, diagnoza, zhvillimi i sëmundjes,...) dhe detajet e mjekimit (dhënja e barnave, rezultatet e analizave dhe të radiografive, ekspertizave, raporteve të operacionit apo të shtrirjes në spital, çertifikatat,...)

Çfarë nënkuptohet me « shënime personale » të profesionelit ?

Disa shembuj të shënimeve personale të profesionelit të shëndetit : shënimet që i shërbejnë si ndihmë e kujtesës dhe që ia mundësojnë menjëherë ta dij se për cilin person është fjala në rast të thirrjes telefonike, apo dokumentet e supervizionit të një mjeku asistent që i shërben veçanërisht që ta analizoj qëndrimin e tij ndaj pacientit. Fakti që vrojtimit shënohen me dorë nuk do të thotë që patjetër bëhet fjalë për shënime personale. Nëse janë pjesë përbërëse të dosjes, pacienti mund të depërtoj në te.

Çfarë ndodh me dosjen mbas vdekjes sime ?

Dosja juaj mbetet e mbrojtur sipas sekretit profesional edhe mbas vdekjes suaj. Të afërmit tuaj nuk kanë mundësi të depërtojnë në dosje vetëm nëse ju ipet leja nga autoritetet mbikqyrëse.

4 - SEKRETI PROFESIONAL

Pacienti ka të drejtë për rrespektin e besueshmërisë për çdo gjë që ka të bëjë mbi gjendjen e tij shëndetësore.

Profesionelët e shëndetit janë të detyruar ta rrespektojnë sekretin profesional, që quhet gjithashtu sekret mjekësor. Ata duhet t'i mbajnë për vete informatat që i kanë mbledhë gjatë praktikës së tyre profesionale. Vetëm nëse parashihet sipas ligjit bën përjashtim, përndryshe, nuk mund të transmetohen pa pëlqimin e pacientit.

Sekreti profesional aplikohet gjithashtu në mes të profesionelëve të shëndetit.

(Sipas nenit 80 dhe 80a të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Sekreti profesional ka për qëllim t'i mbrojtë interesat e pacientit. Është në bazë të raportit të besimit që duhet të ndërtohet në mes të profesionelit të shëndetit dhe pacientit të tij.

Nëse pacienti gjykon që është në interesin e tij, ai mund ta liroj profesionelin nga obligimi që ta ruaj sekretin profesional dhe ta autorizoj që t'i transmetoj informatat personit të tretë. Për shembull mundet gjithashtu në rast nevojë, të kërkojë, që dosja e tij t'i transmetohet një tjetër profesioneli të shëndetit.

Sekreti profesional nuk mund të përdoret kundër vet pacientit, që e ruan çdo herë të drejtën për të qenë i informuar dhe për ta konsultuar dosjen e tij. Profesioneli i shëndetit nuk ka të drejtë ta refuzoj dhënjën e informatave apo konsultimin e dosjes së tij duke nxjerrur si shkak sekretin profesional. Nuk mundet gjithashtu t'i referohet nëse një konflikt e ballafaqon me pacientin e tij.

Sekreti profesional praktikohet edhe në mes të profesionelëve të shëndetit. Vetëm me pëlqimin e pacientit, mjeku mundet t'ia transmetoj elementet e dosjes kolegëve të tij.

Sekreti profesional nuk është absolut. Aq më tepër kur vet pacienti e autorizon profesionelin që t'i komunikoj informatat përkatëse, ky i fundit mund të shkarkohet prej sekretit në disa raste të parapara me ligj:

- Kur një ligj federal apo kantonal e obligon profesionelin t'i informoj autoritetet, disa sëmundje ngjitëse, si tuberkulozi ose meningiti, duhet detyrimisht të lajmërohen pranë autoriteteve të shëndetësisë.
- Profesionelët e kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha rastet që i njohin ku ka të bëjë me keqtrajtimit ndaj të miturve; duhet gjithashtu t'i paraqesin rastet e 'mjekimeve të rrezikshme' apo keqtrajtimeve të shkaktuara nga profesionelët kundër pacientit.
- Ligji federal mbi qarkullimin rrugor parasheh që mjeku mund t'i lajmëron autoritetet që ngasësit i zvogëlohet aftësia për të ngarë.
- Nëse pacienti nuk e autorizon profesionelin t'i jap informatat që i përkasin atij, mjeku mund për arsye të rëndësishme të kërkojë të shkarkohet nga sekretit prej autoriteteve të mbikëqyrjes kantonale. Kjo mund të ndodhë në rastin kur mjeku don ta njoftoj bashkëshortin-en e pacientit-es i cili vuan nga një sëmundje e rëndë ngjitëse me rreziqe të infeksionit.

Është mirë të dihet

Profesioneli a është i detyruar t'ia transmetojë dikujt tjetër informatat që më përkasin mua kur unë kërkoj ?

Po, zakonisht. Megjithatë mund të kundërshtohet në rrethana shumë të jashtëzakonshme, për shembull nëse vlerëson se zbulimi i këtyre informatave mund t'ju shkaktoj fajësi. Përndryshe, nuk mundet ta nxjerrë si arsye sekretin profesional nëse është në konflikt me ju.

Çfarë ndodh me sekretin profesional nëse të afërmit dëshirojnë të marrin informata mbi gjendjen time shëndetësore ?

Profesioneli i shëndetit nuk ka drejtë të transmetojë informatat mbi gjendjen tuaj shëndetësore, vetëm nëse ju e autorizoni. Sekretin profesional vazhdon mbas vdekjes; nëse të afërmit tuaj dëshirojnë t'ju ipen informata pas vdekjes suaj, autoritetet e mbikqyrjes kantonale duhet të japin pëlqimin e vet.

E nëse jam i mitur ?

Ne e konsiderojmë që një pacient i mitur është i aftë prej moshës 14 apo 15 vjeçare përparësisht varësisht nga rasti. I mituri i aftë për të gjykuar i ka të drejtat e njejtë sikurse i rrituri.

Gjithashtu, nëse jeni një pacient i aftë për të gjykuar, keni të drejtë në rrespektimin e besueshmërisë lidhur me gjendjen tuaj shëndetësore. Edhe pse është e preferueshme që vendimet të jenë të marrura me një pëlqim të përbashkët me prindërit tuaj, nëse kundërshtoni që profesionelët e shëndetit t'i informojnë prindërit tuaj, këta janë të detyruar ta rrespektojnë këtë.

Nëse jeni i mitur i ri, mbajtësve të autoritetit prindëror ju takon të marrin vendime që ju përkasin.

E nëse punëdhënësi dëshiron të informohet mbi gjendjen time shëndetësore ?

Mjeku juaj mund ta informoj punëdhënësin vetëm mbi aftësitë tuaja, në pikëpamje të shëndetit, për të përmbushur kërkesat e vendit të punës; ai nuk ka të drejtë t'ia transmetojë kurrfarë diagnoze. Megjithatë nëse ju dëshironi, mjeku juaj mund ta informoj më saktësisht punëdhënësin tuaj ; për këtë duhet ta lironi patjetër nga sekretin mjekësor.

5 - PËLQIM I LIRË DHE I SQARUAR

Asnjë mjekim nuk mund të ipet pa pëlqimin e lirë dhe të sqaruar të pacientit të aftë për gjykim, pa dallim qoftë i rriturit apo i mitur.

Pacienti i aftë për gjykim ka të drejtë ta refuzoj mjekimin, ta ndalojë atë apo ta lëshojë entin shëndetësor nëse ai dëshiron.

(Sipas nenit 23 dhe 23c të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Pacienti i aftë për gjykim ka të drejtë të kundërshtoj një mjekim, ta ndalojë atë apo ta lëshoj entin shëndetësor në çdo moment. Në këtë rast, profesioneli i shëndetit mund të kërkojë nga ai vendimin e tij me shkrim. Ai e informon pacientin për rreziqet që pasojnë si rezultat i këtij vendimi. Pra pacientit i mbetet të marrë përsipër rreziqet që lidhen me mospajtimin e tij për mjekim.

Për të patur mundësi ta jap apo jo pëlqimin e tij të lirë dhe të sqaruar, pacienti duhet të jetë mirë i informuar nga profesioneli i shëndetit. Ky është i obliguar t'i jap informatat e mjaftueshme dhe të plota. Pas kësaj, pacienti i aftë të gjykojë mban të drejtën ta ndërrojë mendimin dhe të jap dorëheqje nga pëlqimi që e ka dhënë.

Asnjë personi të aftë të gjykojë nuk mund t'i imponohet një mjekim nëse ai nuk dëshiron. Mjekimet e detyrueshme janë pra të ndaluara.

Në raste të veçanta dhe në rrethana shumë të përpikta, një mjek mundet megjithatë ta imponoj shtruarjen në spital apo masa të detyrueshme ndaj një pacienti, në rastet kur sjellja e tij paraqet një rrezik të madh për shëndetin, sigurinë e tij apo të tjerëve (për shembull, nëse ai është autor i dhunës apo nëse është bartës i disa sëmundjeve infektuese ngjitëse) dhe nëse çdo masë tjetër ka dështuar (shikoni kapitullin “masat e detyrueshme”).

Është mirë të dihet

Çka është gjykimi?

Të jesh i aftë për gjykim do të thotë të kesh mundësinë ta vlerësosh një situatë dhe të marrësh vendime të rëndësishme në mënyrë të përshtatshme. Aftësia për gjykim duhet të jetë e përcaktuar sipas gjendjes mirë të saktësuar në të cilën ndodhet pacienti dhe sipas pyetjes që shtrohet: çdo herë kur kërkohet marrja e një vendimi aftësia e gjykimit duhet të jetë e vlerësuar.

Çdo person konsiderohet i aftë për gjykim, përveç fëmijëve të vegjël dhe personat që vuajnë nga një sëmundje mendore, dobësim të të menduarit, humbje të vetëdijës, dehje apo për shkaqe të njejta. Në rastet e çrregullimeve psikike, të jeni i moshuar, të jeni nën mbikëqyrje ose të jeni i mitur, nuk është sinonim i paaftësisë për gjykim. Kjo aftësi vlerësohet prej rastit në rast.

Çfarë ndodh nëse nuk jam i aftë për gjykim ?

Para se t'ju ipet një mjekim, profesioni i shëndetit duhet të kërkojë nëse keni dhënë më parë udhëzime të parakohshme ose keni caktuar një përfaqësues terapeutik (shikoni kapitullin “udhëzimet e parakohshme dhe përfaqësuesit terapeutik”). Nëse nuk e keni bërë këtë, profesioni duhet ta marrë pëlqimin prej përfaqësuesit tuaj ligjor. Nëse nuk keni përfaqësues, ai duhet të kërkojë pëlqimin e të afërmeve tuaj, por pa qenë i detyruar ta rrespektoj këtë mendim.

Në rast urgjence ose nëse nuk keni përfaqësues ligjor, profesioni do të veprojë në të mirë të interesave tuaja, duke marrë parasysh dëshirën tuaj të hamendshme.

A është i obliguar profesioni ta marrë pëlqimin tim për çdo ndërhyrje të tij?

Nëse është trajtim jo shumë i fuqishëm (intenziv) ose mjekim rutinor, si për shembull marrja e gjakut apo matja e tensionit të gjakut, miratimi juaj nuk është i obliguar. Për ndryshe, profesioni duhet t'ju pyes nëse pajtoheni ta marrni mjekimin e propozuar.

6 - MASAT E DETYRUESHME

Si parim, çdo masë e detyrueshme ndaj pacientëve është e ndaluar.

(Sipas nenit 23d dhe 23e të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Dispozitat lidhur me masat e detyrueshme zbatohen në të gjitha entet shëndetësore (spitalet, EMS, entet psikiatrike,...)

Një masë detyrimi është një masë e rëndë, e zbatuar pa pëlqimin e lirë dhe të sqaruar të pacientit. Ajo e kufizon lirinë individuale dhe mund ta çënojë dinjitetin e tij. Mbyllja, ndalimi për të qarkulluar lirisht, ose hyrja në kontakt me të afërmit, izolimi, lidhja apo përqëndrimi i fortë i barërave janë për shembull masa të detyrueshme.

Në raste të veçanta, mjeku mund të imponoj masa të detyrueshme pas marrëveshjes me ekipin mjekësor. Por kjo ndodh vetëm kur sjellja e pacientit është e rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e tij apo të tjerëve. Duhet gjithashtu që masa të jetë e proporcionale edhe në rast se masat tjera më pak kufizuese të kenë dështuar.

Mundësisht, mjeku duhet të flet më parë me pacientin, përfaqësuesin terapeutik, përfaqësuesin ligjor apo të afërmit.

Masat e detyrueshme mund të jenë të imponuara vetëm për një kohë të kufizuar. Ato nuk mund të konsiderohen si masa terapeutike. Po ashtu, këto masa nuk mund të arsyetohen me arsyetimin se mungon personeli.

Një masë e detyrueshme duhet të rivlerësohet për të vendosur nëse ajo duhet të vazhdojë apo të ndërpritet. Një protokol i përpiktë duhet të jetë i shënuar në dosjen e pacientit.

Është mirë të dihet

Çfarë është përqëndrimi me barna ?

Është fjala për dhënjen e hapave qetësues, pa qëllim terapeutik të veçantë.

Si kam mundësi t'i kundërshtoj masat e detyrueshme ?

Personi në fjalë, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi terapeutik, të afërmit apo shoqëruarit e tij (shiqoni kapitullin “e drejta për të qenë i shoqëruar”) kanë mundësi t'i drejtohen Komisionit të shqyrtimit të ankesave për të kërkuar ndalimin ose heqjen e masave të detyrueshme. Në rastet e rënda, Komisioni mund të vendosë për një pezullim. Ai duhet ta lëshojë vendimin e vet deri pesë ditë pas paraqitjes së ankesës.

Në rast se është vendosur privimi i lirisë, Komisioni nuk është kompetent. Ankesa duhet t'i drejtohet autoriteteve gjyqësore.

7 - E DREJTA PËR SHOQËRIM

Një pacient që qëndron në një ent shëndetësor ka të drejtë për ndihmë dhe këshilla gjatë tërë kohës sa qëndron i shtrirë.

Ai ka të drejtë të kërkojë përkrahjen e të afërmëve dhe ta mbaj kontaktin me ta.

Nëse dëshiron, ai ka mundësi të kërkojë shoqërues të jashtëm që do të caktohet nga organizatat e pavarura jo fitimprurëse.

(Sipas nenit 20a të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Me kërkesën e pacientit, një shoqërues i caktuar nga një organizatë jo fitimprurëse mund ta ndihmojë në hapat që kanë të bëjnë me shtrirjen në spital ose banimin e tij. Ky shoqërues mund të jetë i pranishëm gjatë bisedës së pacientit me profesionelin e shëndetit ose me autoritetet tjera.

Organizatat jo fitimprurëse që ofrojnë ndihmë duhet të jenë të pranuar nga Departamenti i shëndetësisë dhe i veprimit social (DSAS). Entet kanë në dispozicion një listë me shoqëruesit e caktuar nga shoqatat.

Organizatat që ofrojnë ndihmë janë të detyruara ta bëjnë falas.

E drejta për të qenë i shoqëruar i përket pacientit, jo të afërmëve të tij apo shoqatave. Pacienti mbetet i lirë të vendosë a ka dëshirë ta pranojë viziten e një shoqëruesi apo jo.

Është mirë të dihet

Cilët janë të afërmit e mij ?

Shprehja “të afërmit” nënkupton personat që e njohin mirë pacientin në bazë të lidhjes familjare ose shoqërore me të dhe që tregohen të interesuar për situatën e tij. Është fjala pra për pjesëtarët e familjes, por gjithashtu edhe për personin që banon me te apo miqtë e tij.

Cili është roli i shoqëruesit tim ?

Shoqëruesi juaj ju këshillon dhe ju përkrahë moralisht dhe në menyrë njerëzore. Ai ju ndihmon dhe jua plotëson mungesën e marrëdhënieve sociale, sidomos nëse nuk ju vizitojnë të afërmit tuaj. Ai ju ndihmon në zgjedhjet tuaja dhe në përçapjet lidhur me shtrirjen në spital ose strehimin tuaj.

Përkundrazi, ai nuk ka mundësi t’ju zëvendësojë dhe nuk ka mundësi kurrësi t’ju përfaqësojë.

A ka mundësi të më vizitojë ai që dua gjatë qëndrimit në një ent shëndetësor ?

Po, keni mundësinë të jeni i vizituar nga të gjithë personat që dëshironi (të familjës, të afërmit, njëri i njohur apo të ftuarit), përveç nëse paraqitet ndonjë shenjë e ndonjë smundjeje të rëndë (për shembull në rast të sëmundjeve ngjitëse apo të mjekimit të rëndë).

Si ta gjej një shoqërues gjatë qëndrimit tim në një ent shëndetësor ?

Ju mund të kërkonin nga drejtorja e entit listën e organizatave që propozojnë shoqërues dhe të merrni kontakt me ta. Nëse gjendja juaj nuk ua lejon këtë, mundeni të kërkonin nga personeli ta ndërmarrin këtë përqasje për ju.

8 -UDHËZIMET E PARAKOHSHME DHE PËRFAQËSUESI TERAPEUTIK

Çdo person ka të drejtë t'i shkruaj udhëzimet e parakohshme për ta specifikuar llojin e mjekimit që ai dëshiron ta pranojë apo jo në rast se nuk do të jetë më në gjendje t'i shpreh dëshirat e tij.

Ai ka mundësi po ashtu të zgjedh një përfaqësues terapeutik i ngarkuar të shprehet në vend të tij mbi zgjedhjen se çfarë mjekimi do t'i ofrohet në situatat kur nuk ka mundësi të shprehet.

(Sipas nenit 23a, 23b dhe 23c të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Në rast se një person nuk është i aftë për gjykim, profesioneli i shëndetit duhet të kërkojë nëse ai ka udhëzime të parakohshme apo e ka përcaktuar një përfaqësues terapeutik.

Profesioneli i shëndetit është i obliguar ta rrespektoj dëshirën e pacientit; porse duhet siguruar se ka patur njohuri për këtë. Për ta bërë sa më të qartë dëshirën e tij, është e këshilluar për personin që shkruan udhëzimet e parakohshme t'i lë ato diku ku gjinden lehtë.

Në rast urgjent, profesioneli mund të veproj pa e vërtetuar se a ka lënë pacienti udhëzime të parakohshme. Në këtë rast, ai do të veprojë duke e marrë me mend dëshirën e pacientit.

Udhëzimet e parakohshme mund të ndryshojnë ose të jenë të anuluar në çdo çast.

Nëse pacienti e ka zgjedhur një përfaqësues terapeutik, profesioneli i shëndetit duhet ta informoj ashtu si duhet dhe ta marrë pajtimin për mjekim. Nëse është e nevojshme, nuk mbahet më sekretin profesional para përfaqësuesit terapeutik.

Përfaqësuesi terapeutik duhet të veproj falas.

Nëse një vendim i përfaqësuesit terapeutik e vë në rrezik shëndetin e pacientit, profesioneli ka mundësi ta kundërshtoj dhe të ankohet pranë Gjykatës së Paqes.

Është e këshilluar që pacienti t'ia jap një kopje të udhëzimeve të parakohshme përfaqësuesit terapeutik. Në rast se ky duhet të intervenoj, nuk ka rrezik që të vendos në kundërshtim me dëshirat e pacientit.

Është mirë të dihet

Çfarë janë “udhëzimet e parakohshme” ?

Termi “udhëzimet e parakohshme” përdoret kur flitet për udhëzimet që ju i formuloni paraprakisht në rast se nuk do të jeni më në gjendje që t'i shprehni dëshirat tuaja. Kështu mund ta saktësoni mjekimin që dëshironi t'ju bëhet apo nëse e refuzoni për shkak të principit.

Si t'i formuloj udhëzimet e parakohshme?

Për shkak të qartësisë, është mirë t'i shprehni udhëzimet e parakohshme me shkrim. Keni mundësi të zgjedhni për formën që dëshironi t'ia jepni dhe rubrikat që dëshironi të figurojnë.. Udhëzimet e juaja të parakohshme duhet të jenë të nënshkruara nga ju vet. Nuk është e nevojshme që të keni një dëshmitar.

Edhe nëse nuk i keni shkruar udhëzimet e parakohshme, kuptohet që çdo herë është e mundshme t'i bëni të njohura qëndrimet tuaja gojarisht, për shembull para një operacioni. Keni mundësi t'i anuloni ose t'i ndryshoni udhëzimet e parakohshme në çdo moment. Parimisht, i sillni ndryshimet e rëndësishme për dokumentin me shkrim. Megjithatë, nëse koha nuk pret, për shembull para operacionit, mund ta informoni profesionelin e shëndetit që udhëzimet e parakohshme nuk janë të vlefshme dhe t'ia bëni me dije, çdoherë me gojë, dëshirën tuaj aktuale.

Si të jam i sigurt që do t'i gjejnë udhëzimet e parakohshme në momentin e duhur ?

Keni mundësi ta mbani me vete, t'ia jepni një kopje përfaqësuesit terapeutik (nëse keni një), mjekut që ju trajton, drejtorisë së spitalit, të EMS ose CMS, keni gjithashtu mundësi ta informoni rrethin tuaj.

A duhet që përfaqësuesi terapeutik të jetë një profesionel i shëndetit ?

Jo, ju keni mundësi ta zgjedhni në mesin e familjës, të miqëve, të afërmëve një person që ju njeh mirë dhe në të cilin keni plotësisht besim.

Cilat janë të drejtat e përfaqësuesit terapeutik ?

Përfaqësuesi terapeutik duhet ta jep pëlqimin rreth mjekimit të paraparë: profesioneli i shëndetit është pra i obliguar t'ia jap të gjitha informatat e rëndësishme që ky të vendos për mjekimin duke i marrë parasysh këto informata.

Të drejtat e përfaqësuesit terapeutik fillojnë nga çasti kur ju nuk jeni më në gjendje t'i shprehni dëshirat tuaja apo kur nuk jeni më në gjendje të gjykoni.

Çfarë do të ndodhë nëse nuk i kam dhënë udhëzimet e parakohshme dhe as nuk e kam zgjedhur një përfaqësues terapeutik dhe që nuk jam në gjendje ta gjykoj situatën ?

Nëse nuk keni lënë udhëzime të parakohshme dhe nuk e keni zgjedhur një përfaqësues terapeutik, profesioneli i shëndetit duhet ta marrë pajtimin e përfaqësuesit ligjor para se të veprohet. Nëse nuk keni përfaqësues, ai duhet ta marrë mendimin e të afërmëve tuaj, pa qenë i lidhur nga ky mendim.

Në rast urgjent ose nëse nuk keni përfaqësues ligjor, profesioneli do të veprohet si është më së miri sa i përket interesit tuaj, duke marrë parasysh dëshirën tuaj ashtu si ia merr mendja.

9 - DHËNJJA E ORGANEVE DHE TË INDEVE

Një person mund të vendos përderisa është gjallë t'i japë organet e tij për raste të artisjes (transplantimit). Nëse ai nuk dëshiron që t'ia marrin organet e tij pas vdekjes, ai duhet ta kundërshtoj qartë.

Është e mundur ta kundërshtoni dhënjën e organeve të një të afërmi që ka vdekur, bën përjashtim nëse ai e ka autorizuar.

Dhënjja e organeve dhe e indeve nuk mundet në asnjë mënyrë të jetë objekt i marrëveshjeve tregtare.

(Sipas nenit 27, 27a dhe 27c të ligjit të 29 majit 1985 mbi shëndetin publik)

Praktikisht

Nëse personi i vdekur nuk e ka kundërshtuar dhënjën e organeve për së gjalli, pranimi i tij për dhënjën e organeve merret me mend.

Nëse një person nuk dëshiron t'i jap organet apo indet pas vdekjes, ai duhet të kundërshtojë qartë. Nëse ai nuk e jep asnjë mendim lidhur me këtë, organet e tij mund t'i mirren.

Të afërmit nuk kanë mundësi t'i kundërshtojnë dëshirat që i vdekuri i ka shprehur për së gjalli.

Përkundrazi, nëse personi i vdekur nuk e ka shprehur asnjë mendim lidhur me këtë, të afërmit duhet të jenë të konsultuar dhe kanë mundësi ta kundërshtojnë marrjen e organeve.

Është mirë të dihet

Çfarë duhet të bëj nëse nuk dëshiroj të më mirren organet pas vdekjes sime ?

Ju duhet ta shprehni kategorikisht kundërshtimin për së gjalli. Për këtë, keni mundësi të shkruani në udhëzimet e parakohshme (shiqojeni faqen “udhëzimet e parakohshme dhe përfaqësuesi terapeutik”). Do të ishte mirë ta mbani këtë dokument me vete për t'u siguruar se në rast nevojë do ta gjeni .

Çfarë duhet të bëj nëse dëshiroj t'i jap organet pas vdekjes ?

Për të shprehur qartë dëshirën tuaj, keni mundësi ta mbushni një kartë të dhënësit të Swiss Transplant dhe ta mbani me vete. Kartat e dhënësit janë në dispozicion në barnatore apo mund të porositen drejtpërsëdrejti në Swiss Transplant (0800 570 234).

Nëse dëshironi më shumë informata për artisjet dhe dhënjën e organeve, keni mundësi t'i drejtoheni Qendrës Spitalore Universitare Vaudois (CHUV) dhe Swisstransplant :

- > Centre Hospitalier Universitaire Vaudois (CHUV)
Commission de transplantation, Coordination de transplantation,
CP 2, CHUV, 1011 Lausanne,
tél. : 021/ 314 18 35
e-mail : Coordination.Transplantation@chuv.hospvd.ch

- > Swisstransplant, Fondation nationale suisse pour le don et la transplantation d'organes
bd de la Tour 4, 1205 Genève
tél.: 0800 570 234
www.swisstransplant.org

CFARË DUHET TË BËHET NË RAST TË PROBLEMIT? RRUGËT PËR ANKESË

a. Instancat e ndërmjetësimit të organizatave profesionale

- > Ndërmjetësuesi i Shoqatës vaudoise të mjekësis (SVM)
Société vaudoise de médecine, médiateur
Rte d'Oron 1, CP 76, 1010 Lausanne 10
tél.: 021 652 99 12
- > Komisioni i ndërmjetësimit të Shoqatës vaudoise të mjekëve-dentistë (SVMD)
Shoqata vaudoise të mjekëve-dentiste, Komisioni i ndërmjetësimit
Rue du Valentin 30, Case postale 181, 1018 Lausanne
tél.: 021 351 54 05
- > Dhoma e etikës së Shoqatës vaudoise të enteve mediko-sociale (AVDEMS)
AVDEMS, Chambre de l'éthique, Case postale 607, 1009 Pully,
tél. : 021 721 01 75
- > Komisioni i etikës së shoqatës zvicerjane të infermiereve (ASI)
ASI, Choisystrasse 1, Case postale 8124, 3001 Berne
tél.: 031 388 36 36
- > Zyra e ekspertizës extrajuridike të Federatës së mjekëve zvicerjan (FMH)
Nëse pacienti mendon se një mjek, apo një person nën përgjegjësinë e tij, ka bërë një gabim diagnostik ose terapeutik me pasoja dëmtuese për shëndetin e tij, zyra e ekspertizës e dërgon një ekspert ose një ekipë ekspertësh për ta përcaktuar nëse është bërë ndonjë gabim apo jo.
Zyra e ekspertizës extrajuridike të FMH
Service romand d'information médicale, Rte d'Oron 1, 1010 Lausanne 10
tél.: 021 652 16 74

Gjithashtu, entet shëndetësore emërojnë çdo herë e më shpesh ndërmjetësuesin e tyre ose vendosin një dispozitiv për trajtimin e ankesave. Administrata e entit do t'ju njoftoj.

b. Komisionet kantonale për shqyrtimin e ankesave

Çdo pacient që ka arsye për tu ankuar për një shkelje të të drjetave të tij, ka mundësi t'i drejtohet në çdo kohë njëres nga këto dy Komisione kantonale të shqyrtimit të ankesave. Këto Komisione i trajtojnë ankesat që mirren përsipër nga profesionelët e shëndetit dhe entet. Shëndetësore. Procedura është falas.

- > Commission d'examen des plaintes de patients et Commission d'examen des plaintes concernant les EMS et les divisions C des hôpitaux
Division qualité du Service de la santé publique, Secrétariat
Case postale 183, 1000 Lausanne 17
tél.: 021 316 42 20

KENI NEVOJË PËR NDIHMË, INFORMATA APO KËSHILLA? DISA ADRESA TË NEVOJSHME

> Sanimédia, Shërbim i shëndetit publik

Informon dhe orienton, sipas nevojës, kah burimet e tjera të informative

tel. 0800 106 106

www.sanimedia.ch

info@sanimedia.ch

> Organizimi zvicerjan i pacientëve (OSP)

OSP-ja ka për qëllim kryesor rrespektimin e të drejtave të pacientëve. “OSP këshilla” ndihmon dhe mbron pacientët e ballafaquar me probleme me një terapeut apo një sigurues.

OSP, Conseil et secrétariat romand, rue du Bugnon 21, 1005 Lausanne

tel.: 021 314 73 88,

ligne d'urgence: 0900 56 70 47 (fr2.13/min.);

www.osp.ch

> Federata romande e blerësve (FRC)

Shoqata që i informon konsumuesit dhe i mbron interesat e tyre.

FRC, rue de Genève 7, CP 2820, 1002 Lausanne

tel.: 0900 575 105 (fr. 2.13/min)

www.frc.ch

> Shoqata për mirëqënien e banuesve pranë enteve mediko-sociale (Résid'EMS)

Shoqatë që ndihmon, këshillon dhe informon për pyetjet që kanë të bëjnë me banimin në EMS.

Résid'EMS, av. de Chailly 10, case postale 226, 1000 Lausanne 12

tel.: 021 653 33 44

> Grupi romand i pritjes dhe veprimit psikiatrik (GRAAP)

Shoqatë që ndihmon, këshillon dhe informon personat që janë të ballafaquar me probleme psiqike.

GRAAP, rue de la Borde 23-27, 1018 Lausanne

tel.: 021 647 16 00

www.graap.ch

> Alter Ego Vaud

Seksion kantonal të Alter Ego, shoqatë zviceriane kundër keqtrajtimit ndaj personave të moshuar, që ka për qëllim ta përkrahë dinjitetin dhe rrespektin ndaj personave të moshuar në gjiun e shoqërisë, duke ndihmuar formacionin, kërkesën dhe informacionet.

Alter Ego Vaud, case postale 752, 1000 Lausanne 9

e-mail : alterego.vd@bluewin.ch

> Shoqata zviceriane e të siguruarve (ASSUAS)

Shoqatë që i ndihmon të siguruarit në kuadër të marrdhënjeve me sigurimet.

ASSUAS Vaud, rue du Simplon 15, 1006 Lausanne

Takimet: të hënën prej orës 8 deri në orën 11 në 021 653 35 94

Kujdestari: të mërkurën prej orës 18h 00 deri në orën 20h 00 (me takim) në 021 617 20 33

www.assuas.ch